

Trek



**DASHURIA E TIJ
STUDIM BIBLIK**

Awana[®]

1 East Bode Road
Streamwood, IL 60107-6658 U.S.A.

awana.org
(630) 213-2000

© 2018 Awana[®] Clubs International

2 3 4 5 6 23 22 21 20 19

1

Nënshtrohem

[nënshtrohem]
folje

1. Të jepesh apo të dorëzohesh në fuqinë ose autoritetin e dikujt tjetër.
2. T'i nënshtrohesh një lloj trajtimi apo ndikimi.
3. Të kërkosh aprovim, konsiderim apo vendim nga dikush tjetër.
4. Të deklarosh apo të nxisësh me nderim, të sugjerosh ose të propozosh diçka.

Në mbretërinë e Perëndisë nuk ka zgjedhje me votim, vetëm mundësi për t'iu nënshtruar dëshirave të Perëndisë. Prit pak, çfarë? Po, mirë e dëgjove. Zero vota. Kjo ide mund të jetë tërësisht ndryshe nga gjithçka që ke përjetuar në jetën tënde. Askush nuk zgjohet papritur dhe voton për atë që Perëndia do të bëjë ose jo sot. Ai është Sundues mbi gjithçka. Ai është Mbret i mbretërve. Ai nuk vepron përmes një këshilli drejtues. Perëndia nuk bën kërkesa. Ai jep komanda. Perëndia nuk kërkon nderë. Ai ofron mundësi për të shërbyer. Përse kanë rëndësi këto gjëra?

E po, e ke bërë ndonjëherë pyetjen: Përse jam këtu? Cili është qëllimi yt në këtë tokë? Shumë njerëz besojnë se qëllimi i çdo njeriu është të kujdeset ose t'i shërbejë vetes. Mendojnë se gjithçka lidhet me jetën, planet dhe ëndrrat e tyre. Por, ta kalosh jetën duke jetuar për veten do të të çojë vetëm në pezmatim dhe në mungesë lumturie. Ti je krijuar që ta japësh veten me dashuri për të tjerët (a të kujtohet *duaje të afërmin?*). Nëse beson në Jezu Krishtin, atëherë je këtu për të qenë shërbëtor. Megjithatë, duke ditur rolin, qëllimin dhe qëndrimin e një shërbëtori, mund të jetë e vështirë të jesh i tillë çdo ditë në këtë botë. Kjo është njëra nga arsytet pse Jezusi erdhi në botë. Ai na tregoi se si duhet të jetojë një shërbëtor i vërtetë në nënshtrim ndaj Perëndisë.

Përgjatë këtij libri do të shqyrtojmë disa prej ungjijve, kryesisht Ungjillin sipas Lukës, për të parë se si flet secili prej tyre për Shërbëtorin më të lartë, Jezu Krishtin. Një nga gjërat e para që vëmë re është se Jezu Krishti, dhe shumë të tjerë, historitë e të cilëve janë shkruar për ne, iu nënshtruan vullnetit të Atit. Jezusi nuk ishte i detyruar të vinte. Jezusi nuk duhet të ishte Emanuel (Perëndia me ne). Jezusi nuk ishte i detyruar ta shpëtonte dhe shpengonte njerëzimin. Jezusi nuk ishte i detyruar të të shpëtonte ty. Perëndia mund të kishte lënë gjithë njerëzimin të vdiste në mëkatin e vet. Megjithatë, dashuria dhe qëndrimi i Krishtit janë gjithmonë të një shërbëtori. Nuk do ta shohësh kurrë Krishtin duke u munduar vetëm për veten apo duke i shërbyer vetes. Ai erdhi të bënte vullnetin e Atit që e dërgoi, jo planin dhe agjendën e vet (Gjoni 4:34). Ai erdhi të shërbente. Krishti erdhi që të linte përkohësisht mënjanë disa prej të drejtave të Tij hyjnore, në mënyrë që të bëhej Emanueli (Perëndia me ne) dhe që të na shërbente në mënyrën më të mirë të mundshme. Për këtë do të flasim në një mësim tjetër.

Kujt po i nënshtrohesh? Kujt ia ke dorëzuar kontrollin e jetës tënde? Cila fuqi apo cili autoritet drejton dhe e qeveris jetën tënde? Të gjithë ne përulemi para diçkaje. Të gjithë e nështrojmë veten para dikujt apo diçkaje. Le të njihemi me disa njerëz për të cilët kanë shkruar rrëfyesit e Ungjillit dhe le të shohim se si ata ia nënshtruan vullnetin e tyre Atit, dhe ndoqën mundësinë që Perëndia vendosi para tyre, për t'i shërbyer plotësisht Atit.



**RRUGA drejt
MADHËSHTISË**

MËSIMI 1.1

Bëj një listë të shpejtë të disa njerëzve që njeh personalisht (miq apo të afërm etj.), dhe që ti mendon se janë më të mirët në fushat e mëposhtme. Më pas shkruaj si arritën deri aty. Për shembull: futboll—Armando Broja—punoi fort.

FUTBOLL: _____

KËNGË: _____

MATEMATIKË: _____

TË FOLURIT NË PUBLIK: _____

HUMOR: _____

FJALË KYÇ/ AMBICIE: NJË DËSHIRË E FORTË PËR TË BËRË APO ARRITUR DIÇKA, ZAKONISHT KËRKHEN VENDOSMËRI DHE SHUMË PUNË

MENDIM KYÇ/ QË NJË BESIMTAR TË JETË I MADH SI JEZUSI, DUHET TË BËHET MË PARË SHËRBËTOR.

Në cilën fushë dëshiron të jesh më i miri? Pothuajse të gjithë duan të jenë më të mirët në diçka. Ti mund të dëshirosh madhështi në sporte, në studime, në udhëheqje ose në fitimin e parave. Ose ndoshta je një prej atyre njerëzve që do të jetë më i miri në çdo gjë; ti thjesht do të fitosh. Pikë.

Do të nisim një studim të jashtëzakonshëm të njeriut më madhështor. Në gjithçka. Por mund të themi se Ai kishte një avantazh të padrejtë. Në fund të fundit, Jezusi është Biri i Perëndisë. Ai mund të bëjë mrekulli. Ai është paracaktuar për të sunduar përjetë mbi universin. Ai bëri gjithçka.

Shikoje edhe njëherë listën që bëre me personat më të aftë sipas kategorive përkatëse për të cilat folëm. Për cilat arsye i cilësove si shumë të aftë në futboll, këngë apo humor? Cila ishte rruga që ata ndoqën drejt madhësisë?

Po, disa njerëz kanë lindur me një aftësi të veçantë në një fushë të caktuar, por zakonisht kjo nuk mjafton për ta bërë dikë të madh. Pothuajse në çdo rast duhet shumë punë dhe disiplinë për të qenë më i miri. Por ndonjëherë, edhe talenti i shoqëruar me shumë punë, nuk do të na çojë atje. Kemi nevojë për një përbërës tjetër: ambicie.

Ata që bëhen më të mirët në diçka, zakonisht duhet të duan të jenë më të mirët. Duhet ta duan atë gjë më shumë se kushdo tjetër.

Është shumë e lehtë të habitesh nga bijtë e Zebedeut (Jakobi dhe Gjoni). Ishte një lëvizje e guximshme nga ana e tyre t'i thoshin nënës së tyre, që mund të ketë qenë tezja e Jezusit, që t'i kërkonte Atij t'i bënte ata drejtuesit më të fuqishëm dhe më të rëndësishëm në mbretërinë e Tij, mbi të gjithë dishepujt dhe ndjekësit e tjerë. (Shih Marku 10:35-45 për një këndvështrim tjetër të kësaj ngjarjeje.)

Jezusi nuk u habit. Ai vuri në dukje që: a) ata nuk dinin se ç'kërkonin; b) ata do të pinin nga kupa e Tij (gjë që me shumë mundësi nuk e kuptonin) dhe c) nuk ishte diçka që e vendoste

Ai. (Shih Veprat 12:1-2 për të parë se si më vonë në fakt Jakobi piu nga kupa e Jezusit.)

Por Jezusi nuk i dënoi për ambicien që treguan. Në fakt, Ai u tregoi se si mund të bëheshin të mëdhenj në mbretërinë e Tij. Ai u tregoi udhën drejt madhësisë dhe u tha të ecnin nëpër të.

Dhe cila është udha drejt madhësisë sipas Jezusit?
T'u shërbesh të tjerëve.


Jezusi tha se shërbesa ndaj të tjerëve do të të bëjë të madh. Të bëhesh skllav i tyre, më i vogli prej shërbëtorëve, do të të bëjë të parin.

JEZUSI NUK THA: "MOS JI KAQ KONKURRUES."
AI THA: "JA ÇFARË DUHET TË BËSH PËR TË FITUAR."

A nuk të duket si kleçkë kjo? A duket si një lojë psikologjike super shpirtërore? Mund të të duket ashtu, por nuk është. Jezusi erdhi për të shërbyer dhe Ai është njeriu më i madh që ka jetuar ndonjëherë. Pra, logjikisht, për të qenë të mëdhenj duhet të ndjekim udhën e Tij drejt madhësisë. Dhe ajo është rruga e të shërbyerit.

Por a nuk është egoiste të duash të jesh i madh? Zakonisht mendojmë se ajo që Perëndia do nga ne është të mos duam të jemi të rëndësishëm, të mos duam të jemi më të mirët. Dhe është e vërtetë se Perëndia nuk do që ne të jetojmë për lavdinë njerëzore (Gjoni 5:44). Por madhështia e të qenë si Jezusi vjen kur ne ngremë lart të tjerët, siç bëri Ai. Ai do që ne të duam atë madhështi që vjen nga Perëndia (Jakobi 4:10).

Po ja cili është problemi për shumë prej nesh: Nuk jemi aq ambiciozë sa duhet. Nuk duam të jemi të mëdhenj, në mënyrën e duhur, e aq më pak të bëjmë punën e madhe që kërkohet për të konkurruar me njëri-tjetrin se cili shërben më shumë. Është koha të futemi në lojë.



Ashtu si Biri i njeriut nuk erdhi që t'i shërbehet, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si shpërblese për shumë veta.

Mateu 20:28

Përdor hapësirën e mëposhtme si ndihmë për ta kujtuar këtë varg. Mund të shkruash, të vizatosh ose të projektosh, si të jetë më mirë për ty.

Kur rrëmbejnë dikë të pasur apo të rëndësishëm, personat e afërt presin një kërkesë për shpërblim. Kemi mësuar të presim se rrëmbyesit do të kërkojnë gjithmonë para për ta kthyer personin. Perëndia Atë bëri tërësisht të kundërtën e asaj që mund të prisnim.

Në këtë varg, Jezusi përshkruan misionin e Tij në tokë si një shërbëtor i dërguar për të qenë shpërblimi. Ai ishte personi i rëndësishëm, i dërguar për të paguar me vetë jetën e Tij për ne, njerëzit më pak të rëndësishëm. Dhe ne as nuk ishim rrëmbyer. Ne meritonim të vdisnim për shkak të mëkatit tonë. Ai erdhi gjithsesi të na blinte me jetën e Vet.

LEXO: MATEU 20:20-21

PJESA 3

Kjo nënë i kërkoi Jezusit të bënte diçka për të, para se t'ia tregonte se çfarë ishte ajo gjë. Duket sikur ajo po përpiqej ta manipulonte Jezusin që të thoshte "po" para se t'ia tregonte kërkesën e madhe. Pse?

ZBULO:

Përse nuk funksionon kjo gjë me Perëndinë? Si e tregon ti që beson se Perëndia do të të japë përgjigjen e Tij më të dashur, pa u përpjekur ta manipulosh?

LEXO: MATEU 20:22-23

PJESA 4

Kupa që Jezusi përshkruan është kupa e vuajtjeve. Ai e dinte se do të pinte prej saj shumë shpejt dhe se ata që e ndiqnin do të pinin gjithashtu prej saj. Të ndash madhështinë me Jezusin do të thotë të ndash me Të edhe vuajtjen.

Më pas, Jezusi tregon se, për njerëz të veçantë, Ati ka përgatitur vende nderi në mbretërinë e Tij

ZBULO:

Çfarë tregon përgjigjia e shpejtë që Jakobi dhe Gjoni i dhanë Jezusit? A mendon se ata e kuptuan vërtetë pyetjen e Tij?

Për aq sa ke lexuar nga ky pasazh, ku mendon se do të bazohet Ati kur të përcaktojë kujt i përkasin vendet e nderit?

LEXO: MATEU 20:24-27

PJESA 5

Tronditëse! Dishepujt e tjerë u indinjuan kur morën vesh se Jakobi dhe Gjoni kërkuan vendet e para në qeverinë e Jezusit. Jezusi u tha atyre se drejtuesit në qeverisjen e Tij nuk duhet të keqpërdorin autoritetin e tyre.

Duket sikur Jezusi po u thotë dishepujve: “A dëshiron të jesh i madh në këtë grup, në qeverisjen që po vjen? Nëse po, duhet të zbresësh shkallët. Sa më poshtë të shkosh duke shërbyer, aq më lart do të ngjitesh.”

ZBULO:

Përkruaj një rast kur ke qenë përgjegjës për një grup, por personat që ti drejtoje nuk e praninin autoritetin tënd. Si mundet një drejtues shërbëtor (si Jezusi) t’i bindë njerëzit të bëjnë diçka?

Sa njerëz të mëdhenj njih që u shërbejnë të tjerëve? Drejt kujt mund të përulesh për t’i shërbyer këtë javë? Kush përulet për të të shërbyer ty?

LEXO: MATEU 20:26-28

PJESA 6

Jezusi jep një deklaratë misioni për jetën e Tij dhe për dishepujt në këto vargje. Ai e dinte se çfarë qëllimi kishte dhe nuk kishte jeta e Tij. Ai nuk kishte ardhur që t’i shërbenin. Ai ishte këtu për të shërbyer e për të vazhduar duke shërbyer. Njësoj është edhe për ne.

ZBULO:

Cili mendon se është qëllimi i jetës tënde? Nëse je i krishterë dhe ndjekës i Krishtit, si e tregon jeta jote se je këtu për t’u shërbyer të tjerëve? Nëse jeta jote nuk e tregon, çfarë mund të ndryshosh që të fillosh ta tregosh këtë gjë?

SHËNIMET E FOLËSIT:

PJESA 7

ZBULO:

Çfarë mësove për Jezusin këtë javë? Pse ka rëndësi kjo gjë për ty?

A KE NEVOJË PËR MË SHUMË HAPËSIRË? NGJIT KËTUI

- KONTROLLI I PLOTËSIMIT TË MËSIMIT -

- VEPRIMTARIA HYRËSE
- VARGU PËRMENDSH
- ZBULIMET

FIRMA E DREJTUESIT:

DATA:

A I KE NDJEKUR LEXIMET NGA BIBLA?
SHËNO KËTU ÇFARË KE LEXUAR:

INICIALET E DREJTUESIT: